



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 158, datë 03.10.2016

MBI
AUDITIMIN E VEPRIMTARISË SË BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Autoriteti në funksion të mbikëqyrjes së BSHS-së, referuar pikës 8 të nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrimeve të BSHS-së ndër vite, duke filluar nga viti 2001 e në vazhdim, si dhe vetë angazhimit të APA të BSHS-së (angazhim i parealizuar), konsideron të nevojshëm përzgjedhjen nga APA të BSHS-së, e një shoqërie auditimi ndërkombëtare.

Kjo kërkesë e Autoritetit është diskutuar dhe në mbledhjen e zhvilluar në Autoritet më datë 10.03.2016, me drejtorët e shoqërive të sigurimit, si dhe më pas AMF ka dërguar shkresën nr. 719 prot., datë 17.03.2016, duke kërkuar përfshirjen e disa çështjeve të caktuara në objektin e auditimit të BSHS-së.

Qëllimi i këtij auditimi lidhet me:

- Verifikimin e gjendjes së databazës për dëmet e paguara dhe dëmet e papaguara, si për dëmet me datë ngjarjeje deri në datën 31.12.2013 ashtu edhe për dëmet me datë ngjarjeje pas datës 01.01.2014;
- Siguria dhe vlefshmëria e programeve informatike të përdorura nga BSHS për administrimin dhe ruajtjen e të dhënave;
- Përcaktimin e saktë të detyrimeve që lidhen me dëmet e papaguara, për dëmet me datë ngjarjeje sigurimi deri në datën 31.12.2013;
- Përcaktimin e saktë të detyrimeve që lidhen me dëmet e papaguara, për dëmet me datë ngjarjeje sigurimi pas datës 01.01.2014;

- Analizë për faktorët e rritjes së vlerës së dëmeve të ndodhura (të paguara dhe të papaguara) në 31.12.2016, krahasuar me gjendjen në datën 31.12.2013 duke u fokusuar edhe në dëmet në proces gjyqësor si dëme me vlera të larta;
- Verifikim nëse në databazën e dëmeve të paguara qëndrojnë ende dëme të cilat janë paguar;
- Analizë Run-off për dëmet me datë aksidenti deri në 31.12.2013, të paguara për periudhën 01.01.2014 deri në 31.12.2016;
- Vlerësim për gjetjet e auditimit të kryer nga audituesit e shoqërive të sigurimit sipas shkresës nr. 528, datë 20.01.2015 dhe pasqyrimin e tyre në bilancin e Byrosë apo databazën e dëmeve të papaguara;
- Përputhja e vlerave të dëmeve me pasqyrat financiare të BSHS-së;
- Gjendja e padive të regresit;
- Zbatimin e vendimeve të Bordit të Autoritetit në lidhje me Fondin e Kompensimit.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të urdhërohet Byroja Shqiptare e Sigurimit të procedojë brenda datës 31.10.2016, me përzgjedhjen e shoqërisë audituese ndërkombëtare, me qëllim auditimin e veprimtarisë së BSHS-së që lidhet me gjithë detyrimet e dëmeve objekt i Fondit të Kompensimit.
2. Objekti i Auditimit, përveç të tjerave, të jetë edhe për:
 - a) Verifikimi i gjendjes së databazës për dëmet e paguara dhe dëmet e papaguara në 31.12.2016, si për dëmet me datë ngjarjeje deri në datën 31.12.2013 ashtu edhe për dëmet me datë ngjarjeje pas datës 01.01.2014;
 - b) Siguria dhe vlefshmëria e programeve informatike të përdorura nga BSHS për administrimin dhe ruajtjen e të dhënave;
 - c) Përcaktimi i saktë i detyrimeve që lidhen me dëmet e papaguara, për dëmet me datë ngjarjeje sigurimi deri në datën 31.12.2013;
 - d) Përcaktimi i saktë i detyrimeve që lidhen me dëmet e papaguara, për dëmet me datë ngjarjeje sigurimi pas datës 01.01.2014;
 - e) Analiza për faktorët e rritjes së vlerës së dëmeve të ndodhura (të paguara dhe të papaguara) në 31.12.2016 krahasuar me gjendjen në datën 31.12.2013 duke u fokusuar edhe në dëmet në proces gjyqësor si dëme me vlera të larta;
 - f) Verifikimi nëse në databazën e dëmeve të paguara qëndrojnë ende dëme, të cilat janë paguar;
 - g) Analiza Run-off për dëmet me datë aksidenti deri në 31.12.2013, të paguara për periudhën 01.01.2014 deri në 31.12.2016;
 - h) Vlerësimi për gjetjet e auditimit të kryer nga audituesit e shoqërive të sigurimit sipas shkresës nr. 528, datë 20.01.2015 dhe pasqyrimin e tyre në bilancin e Byrosë apo databazën e dëmeve të papaguara;
 - i) Përputhja e vlerave të dëmeve me pasqyrat financiare të BSHS;
 - j) Gjendja e padive të regresit;
 - k) Zbatimin e vendimeve të Bordit të Autoritetit në lidhje me Fondin e Kompensimit.

3. Periudha e auditimit të jetë nga 01.01.2001 deri në 31.12.2016.
4. Raporti i auditimit të dorëzohet pranë Autoritetit brenda datës 31.01.2017.
5. Byroja Shqiptare e Sigurimit njofton në Autoritet shoqërinë audituese të përzgjedhur brenda 3 ditëve nga data e përzgjedhjes së shoqërisë.
6. Ngarkohen Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI